

**Procesverbal**  
**Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar**  
**Mbajtur më datë 27.11.2025**

**Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.**

**Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.**

1. ALMA KADIASI m
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA m
4. EDMOND KALEMI m
5. ELSA PETRITAJ
6. ERALED ZAIMI
7. ENVER CAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI m
12. MYQERRET HEBIBASI
13. PËLLUMB GURI m
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA m

**Sekretare e Këshillit** deklaroi kuorumin prej 9 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm

Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema

Përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim.

**Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr. 42 prot. të datës 21.11.2025.**

Fjalën e mori Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili kërkoi mirëkuptimin e anëtarëve të këshillit për shkak të emergjencave që janë shkaktuar për nga reshjet e shirave , raportimin e Ujësjiellësit dhe MZSH ta shtymë për mbledhjen e radhës.

Kryetare e Këshillit kërkoi dhe një herë mirkuptimin dhe miratimin për të hequr nga rendi i ditës raportimin e Ujësjiellësit, MZSH dhe për performancën e Bashkisë.

Kryetare e Këshillit u drejtoi pyetjen nëse ka, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Të gjithë këshilltarët shprehën dakortësi me rendin e ditës.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 10:10

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 28.10.2025 dhe 12.11.2025.**

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Këshilltarët shprehin dakortësi .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 10:15

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave**

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të meren në shqyrtim asnjë nga anëtarë e këshilltarët nuk ka shprehur konflikt interesi.

**Pika 4 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Tetor 2025”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili pyet se tek familja refuzuar automatikisht nga sistemi nuk është paraqitur për të bërë deklarin 3-mujor? Pse dhe kur ndërron jetë personi penalizohen?

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se anëtarër madhor ikin dhe jashtë shtetit dhe për kete arsye nuk venë të firmosin deklaratën 3 mujore gjithmonë në muajin Nëntor- Dhjetor ndodh kjo me skemen ekonomike.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh mirë kryefamiljari nuk u gjend ne banesë por dhe kur ndërron jetë personi penalizohen?

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se në momentin që ndërron jetë anëtari i familjes ne bëjmë riaplikim, e heqim atë antarë e çrregjistrojmë nga sistemi dhe bëhet aplikimi në emrin e bashkëshortes që del edhe kryefamiljare dhe është te 6% sepse nuk kishte dalë përfituese dhe ne e kemi trajtuar me fondin e kushtëzuar, nuk është jo përfituese.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 10:25

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 5 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Pranvera Shehu”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Myqeret Hebibasi i cili pyet nëse bashkëshorti është në gjendje të mirë shëndetësore, pse nuk punon?

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se sa do të mund të punoi nuk ja del dot ka tre vajza në shkollë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh të marrë por të plotësohet dokumentacioni.

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:35

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 6 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës financiare, për dëmtimin nga fatkeqësitë natyrore, të banesës së shtetasit Veri Kuka, fshati Nishicë, Nj.A. Qendër ”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Enver Caka i cili shpreh që ti jepet ndihmë z. Hatif pasi janë shumë keq si nga ana ekonomike dhe shëndetësore.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili shpreh se ka folur por nuk ka me çfarë tu bëjë banesën, nëqoftse duan me lekët që marin le të paguajnë njerëz. Un këtë mundësi financiare kamë këtë po shfrytëzojë. Me puntorët e bashkisë kamë ndihmuar kur kanë një punim të përballueshëm po që të shkojnë të bëjnë çati se bëj dot sepse ka shumë që kanë nevojë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se i njeh shumë mirë dhe janë pa qef por edhe mirë të ishin prap nuk do ti bënin dot vetë sepse ajo do ustallarë, por dua të di është ezahuruar i gjithë fondi i emergjencave civile?

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili shpreh se po është zahuruar.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se po thoja për shumën nga 925 miljardë, të japësh dy milion e gjysëm është shumë pak.

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili shpreh se dërgojnë preventivat në Këshillin e Qarkut për të marrë miratimin e tyre.

Me leje fjalën e merr Z. Fikret Telha i cili shpreh se preventivi i paraqitur për Kukën i ka bërë përshtypje, pasi aty thuhet se çatia është vetëm 50 m<sup>2</sup>, ndërsa muret, suvatimet dhe sipërfaqet e tjera rezultojnë ndryshe. Më duket shumë pak si preventiv me një çati 50 m<sup>2</sup>?

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se edhe këtë shumë nuk kanë për ta shfrytëzuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:50

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 7 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës financiare, për dëmtimin nga fatkeqësitë natyrore, të banesës së shtetasit Hatif Mane Brahimasi, lagjja ‘Çlirimi’, qyteti Çorovodë”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:55

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 8 e rendit të ditës “Për kthimin në fond banese të dy objekteve: ish–kopshti i fëmijëve në lagjen Hasan Seitaj dhe ish–zyrat e vjetra të Ndërmarrjes Pyjore, për qëllime strehimi” .**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:05

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 9 e rendit të ditës “Për miratimin e fillimit të procedurës së binjakëzimit midis Bashkisë Skrapar dhe Komunës San Benedetto Ullano, Itali ” .**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:10

Vota pro: 9, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Të ndryshme**

Fjalën e merr z Arjan Hasa i cili shpreh shqetësim për shkollat si Gjergjovë, Backë, Visockë nuk kanë drru për ngrohje, as soba nuk kanë dhe as nuk janë lyer, pa lyer. Përgjegjësi që mbulon arsimin duhet të mari masat më përpara jo ditët e fundit.

Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh e di që ka pasur vonesa me shpërndarjen e drrove të zjarrit në jamë interesuar dhe informacioni që keni ju, është i ditës së martë, sot me sa më kanë informuar çështja është zgjidhur nuk e di nëqoftëse më kanë gënjyer.

Myqerret Hebibasi shpreh se përgjegjësi duhet të mbajti Administratori i zonës jo Kryetari.

Fjalën e merr znj. Mimoza Hysaj e cila e cila shpreh shqetësim për rrugën Buzuq-Spatharë e di që reshjet e shiut bëjnë punën e vetë por rruga është shumë keq të paktën të bëhet pastrim kanali.

Kryetari i Bashkisë, z. Adriatik Mema, e di se duhen bërë ndërhyrje në shumë zona, por kam disa situata që janë vërtet alarmante dhe nuk mund t'i lë pas dore. Do të doja shumë, por kam vetëm një skrep dhe një fadromë. Duhet ta çoj në Rehovë, ku janë bllokuar tre fshatra; ta çoj në Konak, ku ka rënë një shtyllë elektrike dhe e gjithë zona ka mbetur pa energji; në Malind, ku situata është edhe më e rrezikshme; apo të bllokoj rezervuarin e Sevranit, i cili, nëse shpërthen, do të shkaktojë një dëm shumë të madh.

Dua të shtoj edhe diçka tjetër, që mund ta merrni në konsideratë: ka disa bashki që ofrojnë shërbimin e transkriptimit të diskutimeve që bëhen në mbledhjet e këshillit bashkiak, nëpërmjet projekteve të IT që ofrohen nga kompani të ndryshme. Të gjitha diskutimet e anëtarëve të këshillit incizohen dhe automatikisht përpunohen në një procesverbal, kështu që në mbledhjen e radhës nuk ka nevojë që dikush të thotë “këtë ma keni hequr” apo “këtë ma keni shtuar”. Ky sistem është zbatuar në qarkun tonë, në Bashkinë e Beratit, dhe ka funksionuar. Nëse ju, si anëtarë të këshillit, e miratoni, bashkia është e gatshme ta financojë këtë projekt.

Anëtarët e këshillit shprehën dakortësi.

**Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .**

**Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela**

**Kryetare Këshillit Bashkiak: Elsa Petritaj**

**Këshilltarët që firmosin procesverbalin:**

1. Alma Kadiasi

2. Fikret Telha

3. Skerdilajt Jaupllari